



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 258

Tiranë – E enjte, 19 maj 2016

## PËRMBAJTJA

	Faqe
Udhëzim i përbashkët i ministrit të Energjisë dhe Industrisë dhe ministrit të Financave nr. 7455/1, datë 24.12.2015	18065
Për tarifën e shërbimit të kontrollit dhe lëshimit të vërtetimit teknik për subjektet që kryejnë aktivitet në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregtimit të naftës dhe nënprodukteve të saj.....	18065



## UDHËZIM I PËRBASHKËT

Nr. 7455/1, datë 24.12.2015

**PËR TARIFAT E SHËRBIMIT TË  
KONTROLLIT DHE LËSHIMIT E  
VËRTETIMIT TEKNIK PËR SUBJEKTET  
QË KRYEJNË AKTIVITET NË FUSHËN E  
PËRPUNIMIT, TRANSPORTIMIT DHE  
TREGTIMIT TË NAFTËS DHE  
NËNPRODUKTEVE TË SAJ**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 12, 12/1, 13, 14, 15, 16 dhe 23, të ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, nenit 5 të ligjit nr. 9876, datë 14.2.2008, “Për prodhimin, transportimin dhe tregtimin e biokarburanteve dhe lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme për transport”, të ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 970, datë 2.12.2015, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 755, datë 12.11.2014, “Për përcaktimin e procedurave e të kushteve për dhënien e “licencës së përpunimit” për impiantet e përpunimit të nënprodukteve të naftës” dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 19, datë 14.1.2015, “Për procedurat dhe kushtet për dhënien, transferimin dhe përsëritjen e licencës së koncesionit për rafineri për kryerjen e veprimtarisë së përpunimit të naftës bruto për prodhimin e nënprodukteve të saj”, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 432, datë 28.6.2006, “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave që krijojnë institucionet buxhetore”, si dhe në zbatim të pikës 8, të vendimit nr. 114, datë 27.1.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave emergjente, për përmirësimin e situatës së sigurisë dhe të veprimtarive në instalimet e impiantet që shërbejnë për depozitimin, transportin dhe tregtimin e naftës së gazit dhe nënprodukteve të tyre”,

## UDHËZOJMË:

1. Lëshimi, për herë të parë, i vërtetimit teknik nga Inspektorati Shtetëror Përgjegjës (ISHP), në zbatim të urdhrit të ministrit të Energjisë dhe Industrisë nr. 76, datë 18.3.2015, “Për procedurat dhe tarifatat e lëshimit të vërtetimit teknik për

subjektet që kryejnë aktivitet në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregtimit të naftës dhe nënprodukteve të saj”, bëhet kundrejt tarifave si më poshtë:

a) Për licencat e llojit B	300 000 lekë;
b) Për licencat e llojit A, kategoria 0/A	1 500 000 lekë;
c) Për licencat e llojit A, C, kategoritë II/A, II/B, II/C, III/A, III/B, III/C, III/Ç IV/B, V/A, V/B	350 000 lekë;
ç) Për licencat e llojit A, kategoria IV/A (vajra lubrifikante)	200 000 lekë;
d) Për shfrytëzimin e impianteve të prodhimit të hidrokarbureve	1 000 000 lekë;
dh) Për respektimin e normave dhe kushteve teknike në терминалет (depozita bregdetare)	1 500 000 lekë;
e) Për miratimin e projektit teknologjik	100 000 lekë;
ë) Për miratimin e kartës teknologjike	50 000 lekë;
f) Për miratimin e skemës teknologjike	50 000 lekë;
g) Për stacionet e tregtimit me pakicë të karburëve:	
i) Tarifa për lëshimin e vërtetimit teknik, sipas vendndodhjeve të specifikuar, si më poshtë, të jetë	50 000 lekë;

## Sipas akseve:

- Tiranë–Vlorë;
- Levan–Kakavi;
- Tiranë–Kapshticë;
- Tiranë–Hani i Hotit;
- Milot–Morinë.

## Sipas bashkive:

- Tiranë;
- Durrës;
- Fier;
- Vlorë;
- Shkodër;
- Elbasan;
- Korçë;
- Gjirokastër.

ii) Tarifa për lëshimin e vërtetimit teknik për të gjitha rastet e tjera	30 000 lekë;
gj) Për njësitë e lëndëve djegëse	15 000 lekë;
h) Për impiantet e transvazimit të GLN-së, nga cisternat hekurudhore	150 000 lekë.

2. Tarifatat për rinovimet e vërtetimeve teknike të lëshuara sipas pikës 1 të këtij udhëzimi janë sa 30% të tarifave të mësipërme.

3. Udhëzimi i përbashkët ndërmjet ish-METE-s nr. 3528/4, datë 11.6.2009 dhe Ministrisë së Financave nr. 5923/1, datë 1.6.2009, “Për tarifatat e shërbimit të kontrollit dhe lëshimit e vërtetimit teknik për respektimin e normave dhe kushteve teknike të objekteve të ndërtuara dhe shfrytëzuara nga subjekte që ushtrojnë aktivitet në depozitimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, shfuqizohet.



4. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet inspektorati shtetëror përgjegjës.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ENERGJISË DHE  
INDUSTRIË  
**Damian Gjoknuri**

MINISTRI I FINANCAVE  
**Shkëlqim Cani**

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2016

Adresa:  
Bulevardi “Gjergj Fishta”  
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”  
Tel: 042427005, 04 2427006

Çmimi 56 lekë